

Çështje besimi

**Perceptimet e publikut
për sigurinë në Kosovë, 2009/2010**



nëntor 2010

Çështje besimi

**Perceptimet e publikut për sigurinë në Kosovë
2009/2010**

Mirënjohe

Ky raport është shkruar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Saferworld. Autorët e këtij raporti dëshirojnë të falenderojnë Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë dhe atë të Mbretërisë së Bashkuar për financimin e këtij hulumtimi përmes mbështetjes së tyre për projektin VendiSigurt, si dhe njerëzit që jetojnë në Kosovë të cilët janë pajtuar t'i ndajnë perceptimet e tyre me ne.

Shkurtesat

EVS	Ekipe Vepruese për Siguri në Bashkësi
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë
EUSR	Përfaqësuesi Special i BE-së
FIQ	Forum i Iniciativa Qytetare
ICITAP	Programi i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
INPO	Iniciativa për Progres
GD VPBK	Grupi Drejtues për Veprime Policore të Bazuara në Komunitet
KFOR	Forca e Kosovës (NATO)
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
PK	Policia e Kosovës (më parë Shërbimi Policor i Kosovës)
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
AVL	armët e vogla dhe të lehta
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i KB-ve në Kosovë
DD i SHBA	Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve

© Saferworld, nëntor 2010. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem të kthyeshëm apo transmetohet në asnjë formë dhe me asnjë metodë elektronike apo mekanike, të fotokopjohet, incizohet/regjistrohet/mbahet shënim apo në ndonjë formë tjetër, pa atribut të plota. Saferworld mirëpret dhe inkurajon përdorimin dhe shpërndarjen e materialit të përfshirë në këtë publikim.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	i
1. Hyrje	1
2. Konteksti: zhvillimet në sektorin e sigurisë në Kosovë	3
Institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë	3
Siguria në bashkësi në Kosovë	5
3. Perceptimet e publikut për rendin dhe sigurinë	7
Njerëzit ndjehen më të sigurt	7
Bregat kryesore që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë	9
Konflikti i dhunshëm ende perceptohet si i mundshëm	11
Pronësia dhe përdorimi i armëve mbetet çështje e ndjeshme	12
4. Perceptimet e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe qëndrimet ndaj tyre	14
Performanca institucionale, gjendja e sigurisë dhe qëndrimet ndaj ndikimit të politikës në institucionet e sigurisë	15
Perceptimet për institucionet e Kosovës	15
Mungesa e transparencës dhe qasja e kufizuar në informata përkitazi me institucionet	20
Mungesa e mundësive për pjesëmarrje më të madhe	21
Angazhimi qytetar	22
5. Rekomandimet	23

Lista e figurave

Figura 1: A do ta përshkruanit lagjen tuaj si...?	8
Figura 2: Sipas mendimit tuaj, cila është çështja më serioze e rendit dhe e sigurisë me të cilën përballlet bashkësia (komuniteti) juaj?	10
Figura 3: Sa shpesh dëgjoni të shtëna armësh në lagjen tuaj?	12
Figura 4a: Sa besim keni në institucionet e mëposhtme? (nivele të larta besimi)	16
Figura 4b: Sa besim keni në institucionet e mëposhtme? (nivele të ulëta besimi)	16
Figura 5: Në cilën nga këto fusha mendoni se PK-ja ka pasur përmirësim në gjashtë muajt e fundit?	17
Figura 6: Sa ndikim mendoni se kanë njerëzit e bashkësisë (komunitetit) tuaj në vendimet që merren nga qeveria juaj lokale?	21

Përmbledhje ekzekutive

KJO ËSHTË ANKETA E PESTË E KRYER NË POPULLATË që nga viti 2006 nga Saferworld dhe Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) që hulumton qëndrimet e publikut ndaj rendit dhe sigurisë, dhe ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrim të sigurisë në Kosovë. Anketa është paramenduar si kontribut për zhvillimin e institucioneve që i kanë në fokus njerëzit, që janë efektive dhe të përgjegjshme, të afta për t'i ofruar shërbime të sigurisë dhe të drejtësisë gjithë popullsisë së Kosovës. Metodat e grumbullimit të të dhënave (anketë në popullatë e kombinuar me 20 grupe të fokusit që është realizuar në vitet 2009/10, duke shfrytëzuar një pyetësor krahasues dhe metoda model) ndihmojnë në ndërtimin e një tabloje të zgjeruar të ndryshimeve në qëndrime dhe perceptime gjatë periudhës së trazuar të historisë së Kosovës të kohës së fundit.

Në përgjithësi, kjo tablo në pjesën më të madhe është pozitive, por e përzier. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës e ka perceptimin se siguria e tyre është përmirësuar, duke konfirmuar kështu ndryshimin pozitiv të përvitshëm që nga viti 2006. Besimi në institucione të sigurisë vazhdon të rritet, megjithëse ka kontraste të konsiderueshme, për shembull Policia e Kosovës (PK) gëzon besim të gjerë, ndërsa Misioni i Sundimit të Ligjit në Kosovë (EULEX) në përgjithësi gëzon respekt të dobët në mbarë vendin. Prandaj, publiku dhe politikëbërësit mund të marrin njëfarë nxitje nga mënyra sesi siguria dhe ofruesit e sigurisë perceptohen nga shumica e popullatës.

Mirëpo, siç ndodh gjithmonë, një analizë më e thukët e të dhënave paraqet një tablo më të nuancuar. Megjithëse njerëzit mendojnë se niveli i përgjithshëm i pasigurisë në lagjet e tyre është ulur, sërish mbetet frika reale dhe e konsiderueshme e kthimit të konfliktit të dhunshëm; përderisa ekziston një rritje e besimit në institucione, kjo ndryshon me të madhe varësisht nga gjinia, etnia, e deri në njëfarë mase, edhe nga mosha; dhe megjithëse perceptimi për armët e vogla si një faktor i dukshëm në nxitjen e pasigurisë mbetet i ulët, është e qartë se ende ekziston një numër i konsiderueshëm i armëve që mbahen nga civilët anekënd vendit, e të cilat do të mund të përdoren sërish nëse paraqitet nevoja.

Ky raport fillon me prezantimin hyrës lidhur me evoluimin e kornizës institucionale në Kosovë pas luftës, pasi që ajo ndërlidhet me sigurinë dhe ofruesit e sigurisë. Pastaj përshkruhen gjetjet nga anketa e kryer në popullatë dhe nga diskutimet në grupet e fokusit, fillimisht në aspektin e perceptimeve që lidhen me rendin dhe sigurinë, dhe pastaj të institucioneve përgjegjëse për ofrimin e sigurisë. Raporti përmbillet me një sërë rekomandimesh për shqyrtim nga institucionet qeverisëse të Kosovës dhe agjencitë përkatëse mbështetëse ndërkombëtare. Në këto rekomandime hyjnë:

Rekomandimet për ngritjen në shkallë edhe më të lartë të efikasitetit të institucioneve të Kosovës

- Në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe të Planit të Veprimit për Sigurinë në Bashkësi, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë konsultim të gjerë, dhe të marrë parasysh përvojat nga nismat e suksesshme të sigurisë në bashkësi në nivelin lokal dhe atë qendror.

- **Qeveria e Kosovës dhe aktorët tjerë duhet t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar mëtej performancën e Policisë së Kosovës.** Në mënyrë që të shtohet besimi në Policinë e Kosovës si ofrues legjitim të sigurisë, është e nevojshme të rritet mëtej niveli i kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përmirësimit të aftësisë së policisë për të reaguar shpejt ndaj incidenteve, si dhe për të siguruar konfidencialitetin e informatave të pranuar. Nevojitet përmirësim i mëtejshëm në marrëdhëniet ndërmjet PK-së dhe serbëve të Kosovës. Përparimi i arritur në performancën e policisë duhet t'i komunikohet publikut si mjet i vlefshëm për ndërtimin e besimit të publikut dhe të besimit në institucionin e policisë.
- **Duhet të aplikohet qasje gjithëpërfshirëse në promovimin e sigurisë në bashkësi, ku do të përfshiheshin ministrinë kryesore dhe aktorët tjerë në sektorë siç janë zhvillimi i infrastrukturës, drejtësia, shëndetësia, administrata lokale dhe ekonomia.** Meqë shumica e brengave të rendit dhe të sigurisë nuk ndërlidhen drejtpërdrejtë me përgjegjësitë kryesore të ofruesve të sigurisë, aktorët tjerë kyç duhet të përfshihen aktivisht në hartimin e politikave dhe të mekanizmave në nivel kombëtar dhe komunal, e po ashtu edhe në trajtimin e brengave përkritazi me rendin dhe sigurinë në nivel lokal.

Rekomandimet për ngritjen në shkallë edhe më të lartë të mirëkuptimit, të angazhimit me agjencitë ndërkombëtare të interesuara për rendin dhe sigurinë publike në Kosovë

- **Për ta ngritur në një shkallë më të lartë besimin e tij në publik, EULEX-i duhet t'i shqyrtojë mënyrat për rritjen e shkallës së komunikimit me qytetarët** me qëllim të sqarimit të rolit dhe përgjegjësisë të tij dhe për t'i vënë në pah arritjet e tij deri më sot. Kjo do të mund të arrihej përmes vënies së theksit më të madh në shtrirjen e kontaktit të drejtpërdrejt me bashkësitë (komunitetet), me vizita nëpër universitete dhe shkolla të mesme, takime me qytetarë dhe ngjarje të tjera publike, nëpër të cilat qytetarët do të kishin mundësi të shtrojnë pyetje dhe të ngrisin zërin për pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.
- **Institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-i duhet t'i përmirësojnë strategjitë e tyre të koordinimit dhe të komunikimit.** Deklaratat publike të cilat i duken kundërtënëse publikut, mund ta zvogëlojnë edhe mëtej besimin në EULEX dhe ta frenojnë progresin në përmirësimin e mandatit të tij.

Rekomandimet për angazhim më efektiv me publikun e Kosovës

- **Informata më të bollshme dhe më cilësore duhet të vihen në dispozicion të qytetarëve rreth punës dhe qasjes në institucionet e ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë.** Këtu duhet të përfshihen Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSb-të), por edhe institucionet e "reja" siç janë Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK). Në komunat e porsa-formuara, veçanërisht në ato me shumicë serbe, kjo duhet të bëhet me institucionet e Kosovës përgjithësisht, meqë tani për tani ka pak mirëkuptim ose besim në aftësinë e tyre për t'i përmirësuar këto funksione në mënyrë të ndershme.
- **Duhet të përmirësohen mundësitë për angazhim të qytetarëve, si dhe duhet të rritet sensibilizimi i publikut për çdo mundësi ekzistuese për angazhim.** Kjo nuk vlen vetëm për çështjet që lidhen me rendin dhe sigurinë, por me pjesëmarrjen e përgjithshme civile në çështjet e bashkësisë. Përpjekjet në këtë drejtim duhet t'i përfshijnë të gjitha elementet e shoqërisë, përfshirë këtu edhe njerëzit, zëri i të cilëve zakonisht nuk dëgjohet, domethënë gratë, të rinjtë dhe grupet e pakicave etnike.
- **Autoritetet lokale duhet të mbështesin gatishmërinë e publikut për t'u angazhuar vullnetarisht në aktivitetet e bashkësive lokale, në çështjet që i preokupojnë drejtpërdrejt njerëzit.** Ekzistimi i KKSb-ve dhe i forumeve të tjera për rend dhe siguri në nivel të bashkësisë u ofron mundësi autoriteteve lokale që ta shtrijnë kontaktin deri te këto grupe, zëri i të cilëve zakonisht nuk dëgjohet, siç janë të rinjtë, gratë dhe pakicat, si dhe t'i nxisin dhe mbështesin nismat që do të ndihmonin përmirësimin e ambientit të tyre në nivel lokal dhe gjendjen e sigurisë.

1

Hyrje

NË KËTË RAPORT HULUMTOHEN perceptimet e publikut për rendin dhe sigurinë dhe qëndrimet ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrimin e sigurisë në Kosovë. Gjetjet bazohen në diskutimet e zhvilluara në 20 grupe fokusi, të cilat janë zhvilluar gjatë dy periudhave të ndryshme në fund të vitit 2009 dhe në mesin e vitit 2010; anketa e realizuar në tetor të vitit 2009 përfshin 1,200 ekonomi familjare; dhe një numër intervistash me hartues politikash, zbatues dhe komentatorë nga viti 2009 deri në vjeshtë të vitit 2010. Saferworld dhe FIQ i kanë publikuar katër anketa të ngjashme që i përcjellin qëndrimet dhe perceptimet që kanë të bëjnë me një varg çështjesh relevante për sigurinë e njerëzve; një herë në vitin 2006, dy herë në vitin 2008, dhe një herë në vitin 2009¹.

Përveç shqyrtimit të perceptimeve të publikut për rendin dhe sigurinë dhe identifikimit të trendeve përkatëse në këtë fushë, ky raport fokusohet në atë sesi njerëzit në Kosovë i perceptojnë ofruesit e sigurisë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për krijim të politikave dhe mbikëqyrje të çështjeve të sigurisë. Perceptimet që kanë të bëjnë me nivelin e besimit, të pritjeve dhe të performancës vlerësohen, edhe sesi publiku i kupton rolet gjegjëse dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare të angazhuara në Kosovë. Pastaj, në raport shqyrtohet se çka mendojnë njerëzit; a mund të marrin (dhe a marrin) pjesë në vendim-marrje në çështjet e rendit dhe të sigurisë. Në veçanti, trajtohen perceptimet e njerëzve përkitazi me Policinë e Kosovës (PK) dhe Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Mirëpo, përveç kësaj, në raport analizohen opinionet e publikut përkitazi me institucionet e tjera relevante, duke përfshirë autoritetet lokale komunale, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në ofrimin dhe mbikëqyrjen e rendit dhe të sigurisë.

Synimi i raportit është që të kontribuojë në promovimin e ofrimit efektiv dhe të përgjegjshëm të sigurisë në Kosovë. Në raport jepen një numër rekomandimesh që kanë për synim nxitjen e institucioneve të sigurisë për t'i informuar dhe për t'u angazhuar më mirë me qytetarët me qëllim të sqarimit më të madh të roleve dhe përgjegjësi të tyre gjegjëse, si dhe për t'u mundësuar më shumë njerëzve që t'i mbajnë përgjegjëse institucionet. Si i tillë, raporti ka pikësynim organizatat dhe institucionet me bazë në Kosovë, si dhe ato ndërkombëtare që punojnë në ofrimin e rendit dhe të sigurisë në Kosovë.

Në hulumtim kombinohen të dhënat cilësore me ato sasiore. Metodrat e përdorura janë model i anketës së një ekonomie familjare të përzgjedhur rastësisht që bazohet në pyetësorë të detajuar, 20 grupe fokusi që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi nga zona të caktuara anekënd Kosovës, si dhe një gamë intervistash me informues kryesorë, ata që janë përgjegjës për zhvillim, zbatim dhe mbikëqyrje të politikave të

¹ Publikimet e mëparshme të VendiSigurt mund të gjenden në faqen e internetit të projektit www.safeplaceproject.org, shikuar 20 shkurt 2009.

sigurisë. Për të mundësuar krahasimin e përgjigjeve të dhëna në aspektin kohor, si dhe për t'i identifikuar trendet dhe modelet, pyetësorët e anketës përmbajnë një "grup kryesor" pyetjesh të cilat mbeten të njëjta në secilën anketë. Megjithatë, në kuadër të këtij parametri, përmasat e sakta të anketës kanë evoluar pakëz me kalimin e kohës. Për shembull:

1. Numri i të anketuarve është shtuar pak nga 1,153 sa ishin në anketën e parë në dhjetor të vitit 2006 në 1,200 në anketat e tjera (pasuese);
2. Përqindja e shqiptarëve të Kosovës, e serbëve të Kosovës dhe e pakicave të tjera të përfshira në anketa ka ndryshuar, duke pasqyruar ndryshimet zyrtare në përbërjen e popullsisë në Kosovë (në bazë të listës zgjedhore/listës së votuesve);
3. Një pjesë e madhe e kryefamiljarëve në Kosovë janë meshkuj, kështu që për të siguruar një barazpeshë gjinore adekuate, nga viti 2008, femrat janë intervistuar në çdo të dytën dhe të katërtën ekonomi familjare. Për anketën e vitit 2009/10, gjithsej 52.3% e të anketuarve kanë qenë meshkuj, ndërsa 47.7% kanë qenë femra.

Të gjitha vendet e identifikuara në raport janë dhënë me emrat e tyre në gjuhën përkatëse.

Konteksti: zhvillimet në sektorin e sigurisë në Kosovë

Institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë

KY RAPORT VJEN NË KOHËN kur sektori i sigurisë në Kosovë i është nënshtuar një zhvillimi dhe ndryshimi të konsiderueshëm, dhe ku vazhdon të dominohet nga lëvizja e përgjegjësive nga siguria e ofruar nga ndërkombëtarët tek ofrimi i sigurisë që është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës. Në vitet menjëherë pas luftës, ofrimi formal i sigurisë në Kosovë mbikëqyrej ekskluzivisht nga institucionet ndërkombëtare. Forca ushtarake e Kosovës (KFOR) siguronte stabilizim nën udhëheqjen e NATO-s, ndërsa misioni i KB-ve në Kosovë (UNMIK) kishte rol ekzekutiv, që me kalimin e viteve ndryshoi në atë monitorues, si dhe në ofrimin e mbështetjes teknike për institucionet vendore. Me stabilizimin e gjendjes së sigurisë dhe përmirësimin gradual të rendit publik, më shumë theks u vu në forcimin e kapaciteteve të institucioneve vendore të Kosovës, të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ-ve). Kjo përfshinte, themelimin, reformimin, trajnimin dhe pajisjen e institucioneve vendore të sigurisë, për shembull të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Që kur Kosova e deklaroi pavarësinë në shkurt të vitit 2008, Qeveria e Kosovës në masë të konsiderueshme ka marrë përgjegjësinë dhe pronësinë për rendin dhe sigurinë, por për shkak të kompleksiteteve që e rrethojnë statusin e Kosovës, ende mbetet një prani e konsiderueshme ndërkombëtare. Pas miratimit të Kushtetutës së re dhe të Ligjit për Policinë², Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) iu ndërrua emri në Policia e Kosovës (PK). Përveç tjerash, në vitin 2009, u themeluan një numër i institucioneve të sigurisë të parapara me planin e Ahtisaarit³, u miratuan strategji dhe ligje, dhe çka është më e rëndësishmja, FSK-ja u bë operative. Mandati i FSK-së është përmbyshja e përgjegjësive të sigurisë për të cilat agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit (siç është policia) nuk kanë mandat dhe/ose kapacitet për t'i ofruar, duke përfshirë mbrojtjen civile dhe reagimin në kohë krizash. Megjithë perceptimet e shqiptarëve të Kosovës, FSK-ja nuk është armatë me kapacitete të plota; NATO-ja luan një rol të rëndësishëm në trajnimin e personelit të FSK-së dhe në dizajnimin e strukturës organizative të FSK-së, ndonëse FSK-ja është nën kontrollin e autoriteteve të Kosovës, NATO-ja vazhdon të sigurojë mbikëqyrje ndaj operacioneve. Ndër të tjera, Agjencia

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës u miratua në muajin prill dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Ligji për Policinë u miratua nga Kuvendi me datën 20 shkurt 2008, dhe u shpall me Dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës më 15 qershor 2008.

³ Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve e emëroi Marti Ahtisaarin si të Dërguar të Posaçëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Pas 18 muajsh procesi negociator të mbështetur nga KB-të dhe BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, më 26 mars 2007, Martti Ahtisaari paraqiti para Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve Propozimin e tij Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës; Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, S/2007/168, 26 mars 2007. (<http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>)

e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK), të cilët janë të ngarkuara me këshillimin e Qeverisë mbi çështjet e sigurisë⁴, dhe komisionet parlamentare për mbikëqyrjen e AKI-së dhe FSK-së, u themeluan në vitin 2009. Përfundimisht, në vitin 2010, Strategjia e Sigurisë së Kosovës u aprovua nga Qeveria e Kosovës dhe u miratua nga Kuvendi i Kosovës.

Pavarësisht progresit të konsiderueshëm në zhvillimin e sektorit vendor të sigurisë, roli ndërkombëtar në Kosovë mbetet i fuqishëm. Në bazë të Rezolutës 12 44 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u dhe KFOR-i e vazhdojnë praninë e tyre në Kosovë, por me një numër shumë të reduktuar të personelit⁵, duke pasqyruar kështu gjendjen e përgjithshme të përmirësuar të sigurisë. Numri i personelit të UNMIK-ut është rreth 10% i kapacitetit të tij fillestar, dhe pjesa veriore e Kosovës tani është fokusi ekskluziv i operacioneve. Gjatë dhjetë viteve të kaluara, Bashkimi Evropian gradualisht ka marrë rol më të madh, duke përfshirë këtu edhe sferën e sigurisë, ndërsa në vitin 2008, u themelua EULEX-i. EULEX-i gjithnjë e më shumë po merr përsipër detyrat dhe përgjegjësitë që më parë mbaheshin nga UNMIK-u, dhe është i mandatuar që t'u ndihmojë autoriteteve të Kosovës në ofrimin e sundimit të ligjit, në mënyrë më specifike ai ka të bëjë me policinë, sektorët e gjyqësorit dhe të doganave, ndërsa mban pushtet të kufizuar ekzekutiv.

BE-ja si institucion nuk e njeh pavarësinë e Kosovës (ndonëse 22 nga 27 shtetet anëtare e njohin atë), dhe për këtë arsye EULEX-i është “neutral sa i përket statusit”, gjë që është marrë nga shumica e komentatorëve në Kosovë që automatikisht ka këtë domethënie, që ai nuk e njeh pavarësinë. Megjithatë, tabloja e përgjithshme që ndërlihet me rolin e BE-së dhe të institucioneve të saj është më komplekse sesa që do të sugjeronte një gjë e tillë; Përfaqësuesi Special i BE-së (EUSR) po ashtu drejton edhe Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO). ICO-ja i ndihmon Kosovës në zbatimin e ‘planit të Ahtisaarit’ – i cili përcaktoi kornizën për zhvillimin e ardhshëm kushtetues të Kosovës – dhe kësaj e njeh pavarësinë⁶. Megjithëse ka për qëllim të sigurojë bashkërendim dhe unitet të përpjekjeve, kjo gjendje me ‘dy kapela’ në nivelet më të larta të zhvillimit të politikave krijon probleme të vazhdueshme sa i përket qartësisë së qëllimit dhe ndikon në mënyrën sesi qytetarët e Kosovës e shohin EULEX-in, ICO-në dhe BE-në në përgjithësi.

Shumë serbë të Kosovës nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe nuk pranojnë ose nuk bashkëpunojnë me strukturat politike, sociale dhe administrative, dhe institucionet e krijuara nga Qeveria e Kosovës. Në shumë zona të banuara kryesisht me serbë të Kosovës, veprojnë të ashtuquajturat ‘institucione paralele’, të cilat vazhdojnë të mbështeten politikisht dhe financiarisht nga Qeveria e Serbisë në Beograd. Rezultati është një kornizë institucionale komplekse, që çon në mungesë të koherencës dhe të efikasitetit administrativ, sidomos sa i përket sundimit të ligjit dhe ofrimit të sigurisë. Megjithatë, me kalimin e kohës gjendja është përmirësuar në shumë zona të Kosovës. Për shembull, pas bojkotit fillestar pas deklarimit të pavarësisë, shumë policë serbë të Kosovës i kanë rimarrë detyrat; ndërsa në zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2009, serbët e Kosovës kanë dalë për të votuar në numër të konsiderueshëm në kundërshtim me dekurajimin e zëshëm nga Beogradi. Mirëpo, megjithë këto zhvillime pozitive, pjesa veriore e Kosovës kryesisht mbetet jashtë kontrollit të autoriteteve të Kosovës, ndërsa Qeveria e Kosovës dhe EULEX-i kanë bërë progres shumë të kufizuar në shtrirjen e kontrollit të tyre në aspektin e sundimit të ligjit në veri të lumit Ibër. Për rrjedhojë, kjo mbetet me gjasë sfida më e madhe për të ardhmen e Kosovës dhe për cilësinë e ofrimit të sigurisë dhe të drejtësisë që gëzojnë qytetarët e saj.

⁴ SETimes, ‘U inaugurua Këshilli i Sigurisë së Kosovës’, 12 shkurt 2009. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2009/02/12/feature-02.

⁵ KFOR-i është duke e reduktuar numrin e vet gradualisht nga 50,000 ushtarë në vitin 1999 deri në 10,200 në fillim të vitit 2010. KFOR, ‘Roli i NATO-s në Kosovë’, gjendet në: http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm.

⁶ Džihic V. dhe Kramer H., *Kosova pas Pavarësisë – A është duke i përmbushur premtimet e veta Misioni i BE-së, EULEX?* (Friedrich-Ebert-Stiftung, korrik 2009).

Siguria në bashkësi në Kosovë

Përballë këtij mjedisi kompleks, vëmendja në Kosovë gjithnjë më tepër po përqendrohet në ofrimin e sigurisë në nivelet lokale dhe në bashkësi. Ekzistojnë një numër teorish për arsyen e ekzistimit të fokusit të fuqishëm në këtë lëmi; mbase më mbizotëruesi është ai se vënia në qendër të interesimit të nivelit lokal krahasuar me atë qendror bën të mundur që ata që dëshirojnë t'i shohin përmirësimet në rend dhe siguri që përjetojnë nga qytetarët në bashkësitë e tyre për të shmangur hutinë dhe inercionin që vjen me kontekstin e institucioneve të shumëfishta dhe nganjëherë të mandateve konkurruese që vazhdojnë në nivelin kombëtar. Si rrjedhojë, viteve të fundit, në Kosovë janë themeluar disa mekanizma, institucione dhe programe nën termin e 'sigurisë në bashkësi'. Megjithatë, të ndryshme për nga fushëveprimtaria dhe fokusi, synimi i tyre i përbashkët ka qenë promovimi i një qasjeje partneriteti ndaj sigurisë lokale ku përfshihen: përfshirja dhe konsultimi i bashkësive lokale në nivel fshatrash dhe komunash, si dhe zhvillimi i zgjidhjeve të përbashkëta në çështjet e sigurisë lokale dhe ato të sigurisë në përgjithësi; si dhe përfshirja e një game të gjerë të palëve të interesuara në nivel lokal, siç janë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, mediat, autoritetet lokale dhe ofruesit lokal të sigurisë.

Tani institucione të ndryshme punojnë në nivele të ndryshme të shoqërisë kosovare për të promovuar sigurinë në bashkësi:

- **Niveli shtetëror:** Strategjia e Kosovës për Siguri në Komunitet ishte hartuar në vitin 2005, por nuk ishte miratuar nga Qeveria. Më 8 mars 2010, Qeveria vendosi të fillojë procedurën për hartimin e një strategjie të re, me titull 'Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Siguri në Bashkësi'. Puna e sigurisë në bashkësi deri më tani është koordinuar nga Grupi Drejtues për Veprime Policore të Bazuara në Komunitet (GD VPBK). Ndonëse, në kohën kur është duke u shkruar ky raport, PK-ja është duke u riorganizuar dhe është e mundur që si rrjedhojë e kësaj kjo mund të ndryshojë.
- **Niveli komunal:** Meqë Udhëzimi Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka hyrë në fuqi më 20 mars 2009, me ligj kërkohet themelimi i KKSB-ve nëpër të gjitha komunat e Kosovës. KKSB-të kanë qenë, ose në komunat e porsa-formuara pas zgjedhjeve komunale të vitit 2009, janë në procesin e themelimit në të gjitha sosh, përveç tri komunave në pjesën veriore të Kosovës. Sipas Qeverisë, KKSB-ja është 'organi kryesor konsultativ i një komune për çështjet e sigurisë, që në bashkëpunim me policinë, i shqyrton dhe i zgjidh të gjitha çështjet e sigurisë për bashkësitë, në interes të të gjithë qytetarëve në kuadër të komunës'. Prandaj, KKSB-ja është e obliguar që të konsultohet gjerësisht, të mbledhë dhe të analizojë informata dhe në bashkëpunim me policinë, t'i trajtojë dhe zgjidhë brengat e sigurisë. KKSB-të kryesohen nga kryetarët e komunave dhe mes tjerash përbëhen nga komandanti lokal i policisë, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe secila nga bashkësitë fetare, si dhe anëtarët e KLSP-së dhe EVSB-të (shih më poshtë) ku ato ekzistojnë.
- **Niveli lokal/i bashkësisë:** aktualisht ekzistojnë dy struktura: Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP-së) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB-të):
 - KLSP-të aktualisht ekzistojnë në 27 komuna/zona. KLSP-të fillimisht ishin krijuar në vitin 2005 sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi Kornizën dhe Parimet Udhëheqëse të SHPK-së, për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe grupeve të pakicave etnike, si dhe për ta bërë policinë më reaguese ndaj nevojave specifike të këtyre bashkësive⁷.
 - EVSB-të u themeluan në vitin 2003 nga OSBE-ja dhe Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve (DD i SHBA-ve) nën Programin Ndërkombëtar për Asistencë në Trajnim dhe Hetimet Penale (ICITAP). Qëllimi ishte të 'lehtësohej ndërveprimi ndërmjet udhëheqësve të bashkësisë, zyrtarëve komunal dhe Policisë së Kosovës, (në atë kohë,

⁷ Neni 3.2 – Republika e Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 08/2009 MPB – 02/2009 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

⁸ Saferworld, *Siguria Njerëzore në Kosovë – anketë mbi perceptimet* (Londër, maj 2007), gjendet në <http://www.saferworld.org.uk/smartweb/resources/view-resource/266>

Shërbimi Policor i Kosovës) me qëllim të krijimit të marrëdhënieve bashkëpunuese, ashtu që ata të mund të punojnë së bashku në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve të krimit, sigurisë dhe të mirëqenies⁹. Anëtarësia në to synon të përfaqëson bashkësinë në përgjithësi. Tani EVSB-të ekzistojnë në 28 komuna dhe vazhdojnë të themelohen përmes një procesi të parathemelimit, të përzgjedhjes dhe të trajnimit. Në trajnim përfshihen lëndët si komunikimi dhe lehtësimi, partneriteti dhe ndërtimi i ekipit, zgjidhja e problemeve, zgjidhja e konfliktit dhe krijimi i planeve të veprimit. Aktualisht ICITAP-i është në procesin e dorëzimit të përgjegjësisë për mbikëqyrjen e EVSB-ve tek Ministria e Punëve të Brendshme.

Lëmi i sigurisë në bashkësi në Kosovë ka parë disa zhvillime të rëndësishme viteve të fundit, me kornizat institucionale të përcaktuara, me kapacitet më të madh dhe dobi nga përvoja praktike. Një numër nismash në nivel të bashkësive dhe OJQ-ësh nga bashkësitë lokale anekënd Kosovës, si dhe institucione dhe organizata të tjera ndërkombëtare (siç janë UNDP, East-West Management Institute, FIQ dhe Saferworld) kanë kontribuar në zhvillimin e teorisë dhe praktikës së sigurisë në bashkësi në Kosovë.

⁹ OSBE, 'Vlerësimi i Efektit të Ekipeve Vepruese Kosovare për Siguri në Bashkësi', (Bruksel, 2009), f. 14. Gjetet në: http://www.osce.org/documents/mik/2009/03/36621_en.pdf.

3

Perceptimet e publikut për rendin dhe sigurinë

NË KËTË PJESË përshkruhen perceptimet e publikut për çështjet e rendit dhe të sigurisë. Kjo është një vazhdimësi e anketave të mëparshme të realizuara nga Saferworld që nga viti 2006 nën proejktin VendiSigurt, duke bërë të mundur krahasimin e përgjigjeve në pyetjet kyçe me kalimin e kohës. Përveç kësaj, në raport shtjellohen disa nga gjetjet kryesore të anketës më të fundit të kryer në vitin 2009/10. Po ashtu jepet edhe konteksti në të cilin duhet të shqyrtohen marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve që merren me çështjet e sigurisë, të shtjelluara më në detaje në pjesën e mëposhtme. Pikat kryesore janë të përmbledhura më poshtë:


- Perceptimet e përditshme të rendit dhe të sigurisë vazhdojnë të përmirësohen, sidomos në mesin e serbëve të Kosovës. Mirëpo, ende ka zona specifike ku një përqindje e konsiderueshme e njerëzve ndjehen shumë të pasigurt.
- Një pjesë relativisht e madhe e njerëzve ende kanë frikë nga shpërthimi i ndonjë konflikti të dhunshëm gjatë pesë viteve të ardhshme. Shkaqet kryesore duket të jenë çështjet politike të pazgjidhura, por problemet ekonomike dhe sociale po ashtu shkaktojnë frustrim dhe tension, e që perceptohen të kenë potencial për të kontribuar në shkaktimin e konfliktit të dhunshëm.
- Niveli i lartë i kriminalitetit dhe infrastruktura e dobët vazhdojnë të rangohen lart në listën e problemeve, sikurse edhe faktorët e tjerë si ndotja dhe shëndesia. Dhuna në familje dhe ajo gjinore janë çështje të rendit dhe të sigurisë për të cilën nuk flitet shumë nga të anketuarit, por është një çështje e cilat ngritet relativisht shpesh nëpër diskutimet e grupeve të fokusit.
- Njerëzit mbeten ngurrues sa i përket diskutimit mbi përdorimin dhe pronësinë ndaj armëve. Shumica e njerëzve pohojnë se ata nuk do të ndiheshin më të sigurt me armë në shtëpi dhe se nuk do të merrnin një të tillë edhe nëse do t'u lejohej kjo gjë. Njerëzit raportojnë se po ndëgjojnë më shumë të shtëna armësh se në të kaluarën.

Njerëzit ndjehen më të sigurt

Shumica e të anketuarve thonë se ndjehen të sigurt aty ku ata jetojnë. Perceptimet pozitive janë përmirësuar pakëz që nga viti 2008 nëpër të gjitha bashkësitë, pas asaj që ka qenë përmirësim i konsiderueshëm në vitin 2007 dhe në vitin 2008 (shih figurën 1). Sot, 46.4% e të anketuarve e përshkruajnë lagjen e tyre si shumë të sigurt, ndërsa 42.9% deri diku të sigurt. Në Pozharan dhe Viti, të anketuarit e kanë përshkruar të mirë gjendjen e sigurisë publike në bashkësinë e tyre: “(...) nuk ka probleme mes qytetarëve, ose ndoshta vetëm pak (...). Gjatë pushimeve verore unë shkoj në Shqipëri dhe e lë shtëpinë time vetëm për dy muaj. Ka raste kur çelësat i lë brenda shtëpisë, por nuk ka pasur asnjë përpjekje për të hyrë në të (...) në tërë hapësirën sa i përket sigurisë ekziston një bashkëpunim i jashtëzakonshëm”. (mashkull, 43 vjeçar, Viti).

Në përgjithësi, serbët e Kosovës ndjehen shumë më të sigurt sot sesa para një viti, ndërkaq përmirësimi është edhe më i konsiderueshëm nëse përcillet gjatë një periudhe trevjeçare (shih figura 1). Ky është një zhvillim pozitiv i cili mund të jetë për shkak të nocionit se reduktimi i trupave të KFOR-it është tregues i gjendjes së përmirësuar të sigurisë që e përcjell normalizimin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive, e kombinuar me marrjen e detyrave nga policët serbë të Kosovës, si dhe bashkëpunimin e shtuar me strukturat administrative. 70.5% e të anketuarve serbë të Kosovës thonë se ata ndjehen shumë të sigurt ose deri diku të sigurt krahasuar me 56.6% në dhjetor të vitit 2008. Gjatë periudhës së njëjtë, numri i serbëve të Kosovës të cilët ndjeheshin shumë të pasigurt ose deri diku të pasigurt është zvogëluar nga 24.5% në vitin 2008 në 11% në vitin 2009. Përmirësimet dhe sfidat e mbetura mund të ilustrohen me anë të këtyre deklaratave: “Sot (...), unë mund të shkoj deri në Prishtinë dhe t’i plotësoj nevojat e mia. Nganjëherë në të kaluarën, as që kam guxuar të mendoj për këtë gjë, edhe pse ende nuk jam i lirë të prezantohem si serb ose të flas serbisht në çdo vend...” (mashkull, Graçanicë).

Figura 1: A do ta përshkruanit lagjen tuaj si...?
Shumë të sigurt apo deri diku të sigurt



Në figurën 1, rënia në dhjetor 2008 që e then trendin në përgjithësi pozitiv mund të shpjegohet mbase me faktin se të dhënat janë grumbulluar në prill/maj të vitit 2008, vetëm disa muaj pas shpalljes së pavarësisë. Kjo situatë e re politike mund të ketë shkaktuar një ndjenjë të të pamësuarit me të dhe mbase të pasigurisë në mesin e disa të anketuarve.

Në përgjithësi, shumë pak të anketuar e cilësojnë lagjen e tyre si “deri diku të pasigurt” ose “shumë të pasigurt”. Mirëpo, përqindjet janë më të larta për serbët e Kosovës: 8.5% e të cilëve e përshkruajnë lagjen e tyre si “shumë të pasigurt”, kundrejt mesatares në mbarë Kosovën prej 3.3%. Në aspektin gjeografik, dallohet Mitrovica me 9.5% e të anketuarve që e përshkruajnë lagjen e tyre si “shumë të pasigurt” (ndërsa shifrat sillen prej 0.7% dhe 3.6% për rajonet e tjera). Një pjesëmarrës mashkull në grupin e fokusit nga Mitrovica e përshkroi situatën nga kjo perspektivë: “Kur bëhet ora shtatë ose tetë, dhe nëse duhet të dilni jashtë, ekziston një vend (...) deri te Ura mbi Ibër që është si zonë e vdekur. Vetëm pak vetura kalojnë atypari dhe atë çdo gjysmë ore. Është sikur të ishte Siberi ose Grenlandë, ku mund të gjeni vetëm akull, ekziston një qetësi absolute. Ata e kanë bërë këtë zonë me qëllim, ashtu që shqiptarët ose serbët e Kosovës të mos mund të dalin.” (mashkull, 50 vjeçar, Mitrovicë).

Më shumë se tri të katërtat e të gjithë të anketuarve (76.8%) mendojnë se gjendja e sigurisë në lagjen e tyre ka mbetur e njëjtë në gjashtë muajt e fundit, gjersa pothuajse

një e pesta (19.4%) mendojnë se gjendja është përmirësuar. Njerëzit me nivele më të larta të arsimit janë më kritikë në vlerësimet e tyre sa i përket gjendjes lokale të sigurisë, dhe sesi është zhvilluar ajo. Është interesante se madje edhe njerëzit të cilët dëgjojnë shpesh të shtëna armësh (mes një herë në javë dhe çdo ditë), e perceptojnë lagjen e tyre si të sigurt ose shumë të sigurt (më shumë se 70%). Vetëm ata që dëgjojnë të shtëna armësh disa herë në ditë (0.8%), e përshkruajnë lagjen e tyre në mënyrë mbizotëruese si shumë të pasigurt. Fakti se shumica e njerëzve ndjehen të sigurt në lagjet ku ata jetojnë nuk e pakëson frikën e tyre se ndonjëri nga anëtarët e familjes së tyre mund të bëhet viktimë e krimit: më shumë se gjysma e të anketuarve e përshkruajnë veten qoftë si shumë ose mjaft të brengosur se familjet e tyre mund të bëhen viktimë e krimit.

‘Bashkësia’ në të cilën njerëzit jetojnë në përgjithësi shihet si ofruar i sigurisë. Mirëpo, kjo në masë të madhe varet nga ajo se ku jetojnë njerëzit: në zonat dhe lagjet rurale ku të njëjtit njerëz jetojnë që një kohë të gjatë, duket se solidariteti brenda bashkësisë është më i fuqishëm dhe njerëzit ndjehen më të mbrojtur; në qytete dhe sidomos në zona ku ka ndodhur zhvendosje gjatë luftës – dhe risistemim pas saj, duket se ekziston tendenca që njerëzit të ndjehen më pak të mbrojtur nga ‘bashkësia’ e tyre.

Niveli në të cilën njerëzit mendojnë se mund të mbështeten tek fqinjët dhe pjesëtarët e bashkësisë po ashtu varet nga ajo se çfarë lloj kërcënimi i preokupon ata më së shumti. Siç e shpjegon një i anketuar nga veriu i Mitrovicës: „ (...) sa i përket sigurisë në bashkësi, e tëra varet nëse siguria cenohet nga brenda apo nga jashtë. Nëse personi i cili e cenon sigurinë time vjen nga jashtë, përtej urës, atëherë bashkësia ka një rol shumë të madh në mbrojtjen e sigurisë sime personale. Nëse është për çështje të brendshme, atëherë ndjehem krejtësisht i pasigurt. Sepse nuk është askush që të më mbrojë, asnjë institucion ose asnjëlloj grupi joformal që të më mbrojë mua.” (mashkull, 24 vjeçar, serb i Kosovës, Mitrovicë). Perceptimet për sigurinë varen edhe nga ajo se a ndjehen njerëzit se perceptohen si pakica e vetme në një zonë, ose si njëra nga disa grupe të pakicave. Për shembull, një i anketuar nga Shtërpca shpjegon se ai ndjehet më i sigurt kur shkon në Prizren sesa në Ferizaj: “Për arsye se ka shumë boshnjakë që jetojnë në paralagjet e Prizrenit, dhe ata shkojnë në qytet. Për këtë arsye në Prizren nuk mund ta dinë se a jemi serbë apo boshnjakë.” (mashkull, 38 vjeçar, serb i Kosovës, Shtërpce).

Megjithëse familja perceptohet me të madhe si kontribues pozitiv për rend dhe siguri, ekzistojnë dëshmi se shumë femra dhe fëmijë nuk ndjehen të sigurt në shtëpi: “Dhuna ushtrohet edhe ndaj femrave të cilat nuk trajtohen me respekt dhe shpesh trajtohen sikur të ishin kafshë. Shumë bashkëshortë i shtypin ato dhe ushtrojnë dhunë sistematike ndaj bashkëshorteve dhe fëmijëve të tyre (...) fëmijët të cilët janë të detyruar të punojnë ose të cilët shërbejnë si lypës nëpër rrugët e shumicës së qytezave dhe të qyteteve të Kosovës.” (një femër e anketuar nga Istogu). Qartazi kjo është një temë e ndjeshme që me të madhe konsiderohet si tabu dhe për të cilën flitet pak, veçanarisht në formë të hulumtimit formal.

Brengat kryesore që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë

Brengat e përditshme lokale për rendin dhe sigurinë nuk kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë disa viteve të fundit: brengat kryesore mbeten të njëjta, megjithëse rendi me të cilin artikulohej ato ka ndryshuar pak me kalimin e kohës. Kur pyeten për çështjen më serioze të rendit dhe të sigurisë me të cilën është ballafaquar bashkësia e tyre, nga të anketuarit nënvizohen këto çështje:

- 1. Niveli i lartë i krimit:** Frika nga krimi në bashkësi mbetet një problem dhe duket se kjo po shënon rritje me kalimin e kohës (23% në vitin 2009, është ngritur nga 21% në mars/prill 2008 dhe nga 19.1% në qershor 2007). Kjo është një çështje që veçanërisht i preokupon serbët e Kosovës, me dyfish më shumë se norma mesatare (57%) që e identifikojnë këtë si preokupim kryesor. Plaçkitjet, vjedhjet dhe krimet e dhunshme (siç janë sulmet dhe rrahjet) janë kryesisht llojet e zakonshme të krimeve të raportuara para hulumtuesve nga anketuarit. Të rinjtë priren të jenë më të preokupuar me krimet e dhunës në bashkësinë e tyre.

2. Problemet në komunikacion: Brengat që lidhen me ngasjen e pakujdesshme dhe rrugët e rrezikshme janë nënvizuar më shumë se çdo çështje tjetër, dhe ka fituar rëndësi relative (26.5% në vitin 2009, është ngritur nga 15.4% në mars/prill 2008 dhe 14.3% në qershor 2007). Kjo pasqyron gjendjen e dobët të rrugëve të Kosovës, si dhe zbatimin e kufizuar të ligjeve të komunikacionit. Disa pjesëmarrës nga grupet e fokusit kanë shprehur frikën se për të shkuar në shkollë, fëmijët e tyre duhet të ecin nëpër rrugë të pasigurta.


3. Ndotja konsiderohet më e rëndësishme sesa që ishte në të kaluarën. Kjo pasqyron problemet serioze me mjedisin me të cilat ballafaqohen njerëzit në Kosovë në jetën e tyre të përditshme, me ndotjen e ajrit të shkaktuar nga ngrohja me thëngjill dhe lirimet e tij që vijnë nga prodhimi industrial, si dhe kontaminimi i dheut dhe i ujit nga hedhja e mbeturinave. Të lidhura me këto janë edhe preokupimet që lidhen me (disponueshmërinë) ujin e pijshëm në shumë lokacione, gjë që është nënvizuar si çështje serioze në disa diskutime të grupeve të fokusit, e që janë të ndërlidhura ngushtë me preokupimet që kanë të bëjnë me shëndetin publik.

4. Infrastruktura mbetet një brengë e sigurisë publike. Ndriçimi i rrugës që mungon ose që nuk punon dhe mungesa e trotuarëve janë disa nga çështjet që ndikojnë negativisht në siguri në shumë bashkësi.

5. Rreziqet e shkaktuara nga qentë e rrugës dhe shëndetësia publike e dobët se ndajnë vendin e pestë, e të dyja përmenden më shpesh se në të kaluarën. Qentë e rrugës përmenden nga 12.8% e të anketuarve (është rritur nga 4.4% në qershor 2007 dhe 9.7% në mars/prill 2008), ndërsa shëndetësia përmendet nga 12.6% (është rritur nga 6.8% në qershor 2007 dhe 9.4% në mars/prill 2008). Kope qenësh të rrugës ende rëndom shihen në shumë qytete dhe bashkësi të Kosovës, duke shkaktuar frikë në mesin e qytetarëve nga ndonjë sulm i mundshëm. Ata joshen nga mbeturinat e pagrumbulluara dhe mund të paraqesin rrezik sidomos gjatë natës.

Mirëpo, kur ndahen sipas etnisë, nganjëherë ekzistojnë dallime të konsiderueshme mes bashkësive të ndryshme të Kosovës sa i përket asaj se cilat çështje të rendit dhe të sigurisë konsiderohen më seriozet. Përveç nivelit të lartë të krimit, serbët e Kosovës citojnë “zgjidhjen e pafavorshme të statusit të Kosovës” (35.0%, kundrejt vetëm 3.4% të shqiptarëve të Kosovës) dhe “marrëdhëniet e dobëta ndëretnike” (32.5%, kundrejt vetëm 1.9% të shqiptarëve të Kosovës) si brengat e tyre kyçe për rendin dhe sigurinë. Gjersa shqiptarët e Kosovës duket se përqendrohen më shumë në çështjet e rendit dhe të sigurisë publike “lokale” që u shkaktojnë brengosje në mjedisin e tyre që i rrethon, serbët e Kosovës prirën ta shohin gjendjen e tyre lokale të rendit dhe të sigurisë më shumë të lidhur me kontekstin e gjerë politik.

Figura 2: Sipas mendimit tuaj, cila është çështja më serioze e rendit dhe e sigurisë me të cilën përballlet bashkësia (komuniteti) juaj?



Në të dhënat e anketimit, shumë pak të anketuar e kanë përmendur dhunën në familje ose sulmin seksual si lloje të krimeve që ndodhin shpesh në lagjet e tyre (2.5% dhe 0.4%, përkatësisht e të anketuarve). Megjithatë, duhet të vihet në dukje se në diskutimet e zhvilluara nëpër grupet e fokusit, (sidomos në ato në përbërje: të gjitha femra), pikëpamjet e shprehura sugjerojnë se problemet e tilla ekzistojnë në një shkallë më të konsiderueshme, dhe se për shumë femra kjo paraqet një brengë të përditshme të sigurisë. Sikur në shumë vende të tjera, në Kosovë këto janë çështje të ndjeshme që nuk diskutohen haptas: “Ne mund të supozojmë se dhuna në familje ekziston në familjet tona, por ne nuk e dimë këtë me siguri për arsye se njerëzit dhe familjet janë të mbyllura.” (mashkull, 24 vjeçar, Mitrovicë). Fakti se më shumë njerëz nga zonat urbane (4.3%) e përmendin dhunën në familje se ata nga zonat rurale (0.9%) mund të sugjerojë ngurrim më të madh për të folur për këto çështje në bashkësitë më të vogla, dhe nuk duhet të merret se dhuna në familje ndodh më pak në fshatra sesa në qytete të mëdha.

Konflikti i dhunshëm ende perceptohet si i mundshëm

Dhjet vjetë pas luftës, 44.1% e të anketuarve mendojnë se ende ka shumë të ngjarë ose deri diku të ngjarë se do të ketë edhe një konflikt të dhunshëm në 5 vitet e ardhshme. Ndonëse qartazi kjo është brengosëse, prapëseprapë ka përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme (51.1% në dhjetor 2008 dhe 47.7% në qershor 2007).

Në përgjithësi, çështjet politike nga shumica e të anketuarve shihen si shkaqet më të mundshme të përtrirjes së shpërthimit të konfliktit. Këtu hyjnë çështja e pjesës veriore të Kosovës (“Mitrovica/ndarja e Kosovës/siguria e kufijve” – 36%) dhe marrëdhëniet me Serbinë dhe kthimi i personave të zhvendosur (“Serbia/Serbët/Kthimi i serbëve/Moslejimi i ndërtimit të shtëpive” – 19.1%). Mbase nuk është për t’u habitur, perceptimet ndryshojnë mes grupeve me identitet të ndryshëm etnik. Serbët e Kosovës konsiderojnë se përtrirja e konfliktit ka më shumë të ngjarë sesa pjesa tjetër e popullatës (67.5% krahasuar me 44.1%, në përgjithësi), dhe për serbët e Kosovës, “Serbia/ Serbët/ Kthimi i serbëve/Moslejimi i ndërtimit të shtëpive” (35.5%), “konflikti ndëretnik” (34%) dhe “Sulmet e ekstremistëve shqiptarë” (16%) shihen si shkaktarët kryesor të konfliktit. Krimi i organizuar dhe korrupsioni po ashtu janë theksuar si nxitës potencial të konfliktit (18% e serbëve të Kosovës, kundrejt një mesatare prej 8.4%).

Nëpër diskutime në grupet e fokusit, opinionet silleshin mes asaj se a do të mund të shkaktonin konflikt të dhunshëm pakënaqësitë politike. Në këtë kontekst, komentet e mëposhtme nga pjesëmarrësit meshkuj në zonat ku tensionet ndërmjet bashkësisë serbe të Kosovës dhe bashkësisë shqiptare të Kosovës kanë qenë të konsiderueshme, janë mjaft përfaqësuese në gamën e perceptimeve në përgjithësi:

“Mendimi im personal është se konflikti në Mitrovicë me bashkësinë serbe ka mbarruar (...). Ndoshta ndonjë individ mund t’ju qortojë ose t’ju gjuaj me ndonjë gjë, por mendoj se konfliktit masiv me serbët i ka ardhur fundi”. (mashkull, 48 vjeçar, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë).

“Konflikti mund të nisë sërish. Nevojitet vetëm një shkëndijë dhe do të fillojë sërish” (mashkull, 38 vjeçar, serb i Kosovës, Shtërpçë).

Grupi i dytë i nxitësve të konfliktit ka të bëjë me gjendjen ekonomike në Kosovë. Kriza ekonomike globale e ka goditur rëndë Kosovën, dhe kjo ndikon në përgjigjet që kanë dhënë njerëzit kur janë pyetur për shkaqet e mundshme të konfliktit. Papunësia shihet si diçka që çon në probleme siç janë sjellja asociale dhe krimi, dhe shihet si diçka që mund ta minojë rendin dhe sigurinë. Mungesa e optimizmit për të ardhmen, që nganjëherë mund ta përcjellë papunësinë shihet si rrezik i madh për të rinjtë. Një i anketuar nga Vitia bëri këtë koment: „(...) për të rinjtë të cilët dalin veç për kafe dhe nuk mund të gjejnë punë për vete, e vetmja gjë që u mbetet është të dalin të takohen me miq dhe të rrinë nëpër kafene (...) kështu ata pastaj i hynë huliganizmit, kur kanë probleme të rënda. Kur një i ri nuk ka punë, ai ose ajo do të dalë dhe do t’u bashkohet karaktereve më të ulëta” (mashkull, 37 vjeçar, Viti). “Papunësia/Gjendja ekonomike dhe varfëria” janë identifikuar nga 26.1% e të anketuarve si faktorë që kanë potencial të

konsiderueshëm për të shkaktuar konflikt. Të anketuarit me studime post-diplomike konsiderojnë se efekti në konflikt i këtyre tre faktorëve të jetë me rëndësi vendimtare për paqen dhe konfliktin, ndërsa ata me arsim universitar themelor i identifikuan ato si shkaktarët kryesor të mundshëm të konfliktit në të ardhmen.


Pronësia dhe përdorimi i armëve mbetet çështje e ndjeshme

Prania e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Kosovë mbetet e konsiderueshme, edhe pse shumë njerëz janë të vetëdijshëm për rrezikun potencial që lidhet me armët, ende ekziston një pakicë e konsiderueshme (24.2%) e njerëzve që mendojnë se posedimi i armës i bën – ose do t'i bënte ata dhe familjet e tyre më të sigurt.

Në vitin 2009, njerëzit raportojnë se kishin dëgjuar të shtëna armësh më shpesh sesa para 18 muajsh. Megjithatë në prill 2008, 16.2% e të anketuarve kishin thënë se ata asnjëherë nuk kishin dëgjuar të shtëna armësh, ky numër që ulur për gjysmë në 8.2% në tetor të vitit 2009. Se sa shpesh njerëzit dëgjojnë të shtëna armësh varet shumë nga ajo se ku jetojnë ata. Shumica e përgjithshme e të anketuarve, 65.1%, dëgjojnë të shtëna armësh 'disa herë në vit', ndonëse 22.5% e të anketuarve nga Mitrovica i dëgjojnë këto të paktën një herë në javë ose edhe më shumë, (e deri në disa herë në ditë): "Kur vjen vera, njerëzit dalin jashtë dhe shtijnë me armë automatike, do të mendoni se jashtë po bëhet luftë". (mashkull, 48 vjeçar, Mitrovicë).

Shumica dërmuese e njerëzve (80.9%) thonë se ata nuk kanë dëgjuar për incidente në bashkësitë e tyre ku dikush të jetë plagosur me armë zjarri, municion ose eksploziv gjatë gjashtë muajve të fundit. Megjithatë, në diskutimet nëpër grupet e fokusit, të anketuarit përmendin incidente të shkaktuara me armë. Gjuetia dhe të shtënat gjatë kremteve janë rastet kur shtihet më së shpeshti me armë, gjë që mund të shkaktojë aksidente si dhe reagime të paqëllimta nga pjesëtarët e bashkësisë tjetër: "Ne e dijme cila është tradita. E merr armën dhe shtien dy ose tri herë. Por nuk duhet që ta marrësh armën dhe të gjuash pa marrë parasysh njerëzit përreth. Madje edhe nëse je profesionist mund ta bësh gabimin fatal, e jo më që këta njerëz janë amatorë" (mashkull, 48 vjeçar, Mitrovicë).

Figura 3: Sa shpesh dëgjonit të shtëna armësh në lagjen tuaj?



Sikur në vitet e mëparshme, ka shumë paqartësi për atë sesa ekonomi familjare kanë armë (më shumë se 50% e të anketuarve thonë se ata nuk e dinë), gjë që tregon për vështirësinë ose mosgatishmërinë për të folur për këto çështje, si dhe për mosdijen e vërtetë. Megjithatë, 18.3% e të anketuarve mendojnë se armë ka në të paktën një të katërtën e ekonomive familjare në lagjet e tyre. Për më tepër, nuk ka ndonjë korrelacion ndërmjet vlerësimeve të përafërta të të anketuarve lidhur me posedimin e armëve dhe asaj se a e konsiderojnë ata zonën ku jetojnë të sigurt ose jo.

Perceptimi i përgjithshëm se armët e zjarrit nuk e ngrisin në shkallë më të lartë rendin dhe sigurinë publike mbetet konstant dhe shumica e të anketuarve ende thonë se nuk do të merrnin armë edhe po t'u jepej mundësia (73%). Për ata që thonë se do të merrnin armë nëse do të mundnin (23.8%), mbrojtja e familjes përmendet si arsyeja më kryesore. Për të anketuarit serbë të Kosovës që thonë se ata do të zgjedhnin të kenë armë zjarri nëse do t'u jepej mundësia (26.5%), rëndësia e mbrojtjes së familjes është rritur gjatë vitit të kaluar (nga 82.7% në dhjetor të vitit 2008, në 94.3% në tetor të vitit 2009), ndërsa mbrojtja e interesave të biznesit është ulur (nga 38.5% në 15.1% gjatë periudhës së njëjtë)¹⁰.

Bashkë me rezultatet nga anketa e vitit 2008¹¹, ende ka skepticizëm se një amnesti e armëve që ka për synim bindjen e njerëzve për t'i dorëzuar armët në posedim të paligjshëm do të ishte e suksesshme, megjithë refuzimin e mbajtjes së armëve nga publiku i përgjithshëm dhe perceptimeve krahasuese të sigurisë në nivelin lokal. Vetëm 8% e të anketuarve mendojnë se të gjithë ose pothuajse të gjithë pronarët e armëve do t'i dorëzonin ato, ndërsa 17.3% mendojnë se asnjëri ose gati asnjëri nuk do ta bënte një gjë të tillë. Duket se nuk ka korrelacion të fortë ndërmjet të të anketuarve përkitazi me atë se sa e suksesshme do të mund të ishte një fushatë për grumbullimin e armëve dhe asaj se a e perceptojnë ata lagjen e tyre si të sigurt ose jo, duke nënkuptuar se arsyet e supozuara për pronësi ndaj armëve kanë më shumë të bëjnë me faktorët që kryesisht ekzistojnë jashtë bashkësisë, siç janë zhvillimet politike kombëtare ose rajonale.

Megjithëse një amnesti e përgjithshme nuk shihet si një instrument posaçërisht i dobishëm për të ulur numrin e posedimit të armëve, ka pasur njëfarë mbështetje për idenë që u përpunua në mënyrë specifike se edukimi pjesëmarrës i publikut dhe fushatat e sensibilizimit do të mund të kontribuonin në ndryshimin e qëndrimeve ndaj pronësisë dhe përdorimit të armëve në posedim të paligjshëm. Anketa ka treguar se një numër më i vogël i të anketuarve në Ferizaj raportonte se ndiheshin më të sigurt me armë, ose thanë se ata do të mund të merrnin parasysh marrjen e një arme në krahasim me trevat tjera. Kjo është me interes sepse Ferizaj ka qenë fokusi dhe pikësynimi i një fushate publike të udhëhequr në nivel lokal, e fokusuar në ndryshimin e qëndrimeve të të rinjëve ndaj posedimit të armës.

¹⁰ Kjo pyetje lejon përgjigje të shumëfishta dhe si rrjedhojë shuma e përgjithshme nuk mbledhet në 100%.

¹¹ Saferworld 'Gati ose Jo? Kërkimi i perspektivave për grumbullimin e armëve të vogla dhe të lehta të paligjshme në Kosovë' (Londër, korrik 2009). Gjetet në: <http://www.saferworld.org.uk/smartweb/resources/view-resource/403>

4

Perceptimet e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe qëndrimet ndaj tyre

NË KËTË PJESË, TERMI INSTITUCIONET e sigurisë përshkruan një gamë të gjerë organizatash, duke përfshirë autoritetet komunale të cilat mund të jenë përgjegjëse për çështjet që lidhen me sigurinë publike siç janë siguria në rrugë. Gjetjet e raportit, sa u përket perceptimeve të njerëzve për këto institucione janë të përshkruara në këtë pjesë dhe mund të përmbliidhen si vijon:

- Besimi i njerëzve në institucione varet jo vetëm nga perceptimi i performancës së tyre, por edhe nga (a) ajo sesa të sigurt ndjehen njerëzit në përgjithësi, dhe (b) ajo sesi institucionet në fjalë shihen të përshtaten me pikëpamjet e gjera politike të ndonjë individi përkitazi me Kosovën bashkëkohore. Përveç kësaj, duket se perceptimi që mund të ketë një individ për një institucion të veçantë, shpesh mund të jetë i ngjyrosur me mungesë të njohurisë rreth rolit të saktë të tij; mungesa e qartësisë në këtë aspekt mund të krijojë dyshime dhe mund ta minojë besimin në të.
- Nga të gjitha institucionet në Kosovë të përkushtuara ndaj ofrimit të sigurisë, në përgjithësi më së shumti i besohet Policisë së Kosovës, sidomos në mesin e popullatës shqiptare të Kosovës dhe njerëzit besojnë se performanca e Policisë së Kosovës është duke u përmirësuar. Megjithatë, autoritetet komunale janë institucioni të cilit i besojnë më së shumti në masë të barabartë të gjitha bashkësitë. Kjo është e mundur për arsye se autoritetet lokale perceptohen se i adresojnë çështjet që janë më afër jetës së përditshme të njerëzve dhe se i përfaqësojnë individët që jetojnë në kuadër të një zone gjeografike të caktuar: ndonjëse është e paqartë nga ky hulumtim nëse njerëzit u besojnë autoriteteve të tyre komunale për arsye se i perceptojnë se ato i përfaqësojnë interesat e tyre, apo institucionin e autoritetit komunal; kjo është një fushë që kërkon hulumtim të mëtejshëm.
- Nga institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, KFOR-i mbetet më i besueshmi, ndërsa duket se EULEX-i gëzon më së paku mbështetje, ku të gjitha bashkësitë shprehin shkallë të lartë të mosbesimit dhe/ose të zhgënjimit në performancën e EULEX-it, dhe mungesën e qartësisë për mandatin dhe rolin e këtij misioni.

- Njerëzit besojnë se nuk ka mjaft mundësi për të marrë pjesë në vendim-marrje për çështjet e sigurisë. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i njerëzve duket se nuk besojnë se mund t'i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre para institucioneve që ofrojnë siguri; kjo sidomos për bashkësitë pakicë. Megjithë skepticizmin e mbajtur gjerësisht rreth asaj se a janë në gjendje të ndikojnë në punët lokale, njerëzit në përgjithësi janë të gatshëm të jenë vullnetarë në projekte që do të ndihmonin në përmirësimin e mjedisit të tyre lokal dhe të gjendjes së sigurisë.

Performanca institucionale, gjendja e sigurisë dhe çështjet politike ndikojnë në qëndrimet ndaj institucioneve të sigurisë

Në përgjithësi, shumë njerëz në Kosovë kanë një besim të kufizuar në institucione, si në ato të Kosovës, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Nivelet e besimit që njerëzit kanë në institucionet kryesore, përgjegjëse për rend dhe siguri varen nga shumë faktorë; ku hyjnë performanca; brengat lokale të sigurisë, si dhe pikëpamjet nëse ai institucion mendohet që po punon në favor ose kundër interesit të bashkësisë.

Ekziston një korrelacion i fortë ndërmjet të nivelit të besimit të të anketuarve në polici dhe në autoritetet komunale nga njëra anë dhe perceptimeve pozitive për rendin dhe sigurinë nga ana tjetër: 56.5% e atyre që i besojnë 'plotësisht' dhe 45.7% e atyre që i besojnë 'shumë' Policisë së Kosovës (PK), i përshkruajnë lagjet e tyre si shumë të sigurta. Nga ana tjetër, prej atyre që nuk i besojnë aspak PK-së, vetëm 24% i perceptojnë lagjet e tyre si shumë të sigurta, dhe 17% i perceptojnë ato si shumë të pasigurta. Për autoritetet komunale, korrelacioni është pakëz më i ulët: 57.4% e atyre që u besojnë plotësisht dhe 50.4% e atyre që u besojnë shumë autoriteteve komunale thonë se jetojnë në një lagje shumë të sigurt. Vetëm 1.4%, gjegjësisht 1.5% thonë se lagja e tyre është shumë e pasigurt, ndërsa 39.1% e atyre që nuk u besojnë aspak autoriteteve të tyre komunale, kanë perceptimin se lagjet e tyre janë shumë të sigurta, ndërsa 7.2% si shumë të pasigurta.

Dallimi ndërmjet bashkësive të ndryshme sa i përket nivelit të besimit ndaj një institucioni të dhënë është i konsiderueshëm, ku pjesërisht pasqyrohet konteksti politik në të cilin veprojnë këto institucione. Në përgjithësi, serbët e Kosovës kanë më pak besim në institucione se çdo grup tjetër. Ata më së shumti kanë besim në komuna (28.5% u besojnë plotësisht ose shumë), dhe më së paku u besojnë institucioneve shtetërore të Kosovës, siç janë Forca e Sigurisë së Kosovës (74% nuk i besojnë 'aspak'), Qeverisë së Kosovës (72.0% nuk i besojnë 'aspak' – megjithëse ky është një përmirësim nga viti 2008, kur shifra ishte 84.2%) dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (71.0% nuk i besojnë 'aspak'). Sa u përket institucioneve ndërkombëtare, serbët e Kosovës i besojnë më shumë KFOR-it (17.5% nuk i besojnë aspak, 32.5% i besojnë pak, dhe 34.5% thonë se as i besojnë, e as nuk i besojnë), ndërsa EULEX-i kalon edhe më keq: 44.5% thonë se nuk i besojnë aspak EULEX-it.

Perceptimet për institucionet e Kosovës

Sikurse në anketat e mëparshme¹², Policia e Kosovës del mirë në aspektin e besimit të publikut: ajo gëzon në mënyrë të konsiderueshme nivelin më të lartë të besimit nga të gjitha institucionet shtetërore, megjithëse siç u theksua më lart, mbetet një dallim i konsiderueshëm ndërmjet bashkësisë shqiptare të Kosovës dhe bashkësisë serbe të Kosovës, dhe ndërmjet bashkësive serbe të Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, dhe atyre që jetojnë diku tjetër. Në përgjithësi, 76.8% e të anketuarve i besojnë PK-së shumë, ose plotësisht, e pasuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) me 76.0%. Qeveria e Kosovës dhe Gjyqësori janë institucionet të cilave u besohet më së paku në Kosovë, me 22.8% dhe 22.3% gjegjësisht, që u përgjigjën se nuk u besojnë atyre 'aspak'.

¹² Për anketën e mëparshme, shih faqen e internetit të projektit www.safeplaceproject.org.

Figura 4a: Sa besim keni në institucionet e mëposhtme? (nivele të larta besimi)





Figura 4b: Sa besim keni në instituconet e mëposhtme? (nivele të ulëta besimi)




Policia e Kosovës

Jo vetëm që njerëzit i besojnë më shumë PK-së se institucioneve të tjera, por kur pyeten se në cilën prej tri fushave ata mendojnë se PK-ja ka përmirësuar performancën e vet, dy të tretat (66.0%) e të anketuarve kanë parë përmirësime në patrullimet më të shpeshta, 43.0% mendojnë se PK-ja po i trajton njerëzit më me respekt, 39.4% mendojnë se PK-ja po reagon më shpejt ndaj incidenteve¹³ dhe 26.8% mendojnë se PK-ja është bërë më pak e korruptuar.

Sikurse edhe me institucionet e tjera, bashkësitë janë të ndara në qëndrimet e tyre: vetëm 6% e serbëve të Kosovës i besojnë shumë ose plotësisht Policisë së Kosovës, ndërsa 27% nuk i besojnë aspak. Këto shifra kanë mbetur kryesisht të pandryshuara gjatë tri viteve të kaluara. Megjithatë, shumë serbë të Kosovës shprehin njëfarë besimi në policët serbë të Kosovës në PK: 43.5% u besojnë shumë ose plotësisht policëve serbë të Kosovës, ndërsa 32.5% përgjigjen në mënyrë më neutrale “as i besojnë, e as nuk i besojnë”.

Sidoqoftë, megjithë këto zhvillime pozitive, diskutimet në grupet e fokusit kanë nxjerrë në pah edhe atë se shumë njerëz ende mendojnë se ka nevojë për përpjekje më të mëdha për të përmirësuar kapacitetin e policisë, sidomos kohës së nevojshme të reagimit të PK-së ndaj incidenteve. Disa mendojnë se mandati i PK-së nuk parasheh mjaft fushëveprim për të intervenuar në parandalim të krimit ose kapjen e të dyshuarëve. Pikëpamje të ngjashme mund të dëgjohen – veçanërisht nga disa gjenerata më të vjetra – në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, ku policia më parë ka pasur pushtet shumë më të gjerë. Në pjesën veriore të Kosovës, njerëzit mendojnë se mandati i policisë nuk është i përshtatshëm për shkak të kontekstit lokal të vështirë “Policia ka disa kompetenca të cilat ende janë të kufizuara, sidomos në Mitrovicë. Ata po përpiqen të punojnë sa më mirë që mundën, por në Mitrovicë ne jetojmë në rrethana të ndryshme nga ato në Prizren ose në qytetet tjera. Por duke marrë parasysh rrethanat, ne mund të themi se ata po bëjnë përpjekje” (mashkull, 45 vjeçar, Mitrovicë).

Figura 5: Në cilën nga këto fusha mendoni se PK-ja ka pasur përmirësim në gjashtë muajt e fundit?



Shumica dërmuese e të anketuarve (93.3% gjithsej) thonë se ata do ta raportnin krimin në polici, nëse ai do të kryhej kundër tyre ose pjesëtarit të familjes së tyre. Kjo ndodh pavarësisht përkatësisë etnike dhe nivelit të përgjithshëm të besimit që të anketuarit kanë në policinë. Në mesin e atyre që thonë se ata nuk do të dëshironin ta raportnin krimin, arsyeja më e zakonshme që është dhënë (68%) ishte besimi se policia nuk do ta kapte keqbërësin ose se nuk do ‘ta zgjidhte’ krimin.

¹³ Këto kanë qenë shifrat e grumbulluara: të anketuarit kanë dhënë nga tri përgjigje secili dhe prandaj shumica e përgjigjeve është 300%.

Në diskutime, njerëzit shprehin më shumë ngurrim kur bie fjala te raportimi në polici i një personi të caktuar që ka kryer një krim: ata druajnë se raporti i tyre nuk do të trajtohet me konfidencialitet dhe se keqbërësi do ta zbulonte se kush e ka raportuar në polici. Mungesa e besimit në konfidencialitetin e policisë shihet si pengesa kryesore në marrëdhëniet polici-bashkësi, të cilat përndryshe perceptohen në dritë pozitive: “Nëse policia do të ofronte mbrojtje për dëshmitarët me siguri se bashkëpunimi do të ishte më i madh. Sepse do të frikësohesha të dëshmoj kundër dikujt, sepse ata nuk ofrojnë mbrojtje” (mashkull, 21 vjeçar, Ferizaj).

Për ata që nën-stacionin e policisë e kanë afër shtëpisë së tyre, prania e nën-stacionit bën që 70.1% e të anketuarve të ndjehen të sigurt. Kur pyeten së kë do ta thirrnin nëse ata ose familja e tyre do të kërcënohej me dhunë, 87.7% thonë se do ta thirrnin PK-në. Megjithatë, ende ekziston një përqindje e konsiderueshme (33.5%) e njerëzve të cilët do të preferonin të mbështeten tek vetja ose tek pjesëtarët e familjes, fqinjët ose miqtë për mbrojtje sesa të thërrisnin policinë ose aktorët e tjerë zyrtarë të zbatimit të ligjit¹⁴. Sidomos serbët e Kosovës e shohin këtë si zgjedhjen e tyre të parë (72%) – një shprehje mbase e niveleve përgjithësisht të ulëta të besimit të serbëve të Kosovës në PK dhe në institucionet tjera të sigurisë. Arsyet që i dhanë njerëzit nëpër diskutimet e grupeve të fokusit përqëndroheshin në atë se a do të reagonte me kohë PK-ja ndaj ndonjë incidenti: “Unë mendoj (fqinjët janë) më afër se policia për arsye se fqinji mund të vijë e të më ndihmojë shumë më shpejt se policia. Policia gjithmonë vjen tepër vonë, përveç nëse ke ndonjë të afërm që punon atje.” (femër, 20 vjeçare, Ferizaj).

Autoritetet komunale dhe qeverisja lokale

Në përgjithësi, 62.4% e të anketuarve u besojnë “plotësisht” ose “shumë” autoriteteve komunale. Është grupi i vetëm i institucioneve që gëzojnë besimin e një pjese të konsiderueshme të bashkësisë serbe të Kosovës (28.5%) por edhe të bashkësisë shqiptare të Kosovës (62.4%). Në të njëjtën mënyrë, të pyetur se sa ka të ngjarë që institucione të ndryshme qeveritare do ta përmirësojnë standardin e tyre të jetesës, “qeveria lokale” ka marrë më së shumti pikë (56%), me dallime të vogla ndërmjet bashkësive. Kjo tregon se autoritetet komunale shihen si më pak të kontestuara, pasi që kanë më shumë të ngjarë të merren me çështjet e përditshme që janë më afër jetës së njerëzve siç janë transporti publik, shërbimet komunale dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, dhe si rrjedhojë më pak të ndërlidhura me politikën e niveleve të larta të cilat i përçajnë bashkësitë.

Diskutimet nëpër grupet e fokusit dhe intervistat e realizuara në vitin 2010 në Ferizaj, Shtime dhe Graçanicë kanë ofruar një tablo më të nuancuar të asaj sesi perceptohen strukturat komunale, përfshirë këtu edhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Në përgjithësi, njerëzit besojnë që aktorët komunalë siç janë KKSB-të mund ta përmirësojnë gjendjen e sigurisë. Madje edhe në Graçanicë, njëra nga komunat e porsa-formuara serbe, njerëzit ose janë të pasigurtë se çfarë të presin nga strukturat e reja komunale, ose shpresojnë në ndryshime për të mirë: “Pritjet janë të mëdha, por çka do të ndodhë në praktikë mbetet të shihet. Megjithatë, mund të them se njerëzit janë optimistë në lidhje me këtë çështje” (ndërmarrës, Graçanicë).

Duket se ka bashkëpunim të kënaqshëm ndërmjet aktorëve të ndryshëm përgjegjës për ofrim të sigurisë dhe rendit publik, siç janë autoritetet komunale, Zyra për Siguri dhe Emergjencë, policia, shkollat dhe OJQ-të. Megjithatë, ka mungesë të shtrirjes së kontaktit dhe të bashkëpunimit me publikun e gjerë. Shumë njerëz nuk kanë dëgjuar asnjëherë për KKSB-të, dhe ekziston perceptimi se “komuna kurrë nuk na fton për konsultime, përveç në kohën e zgjedhjeve.” (ndërmarrës, Shtime).

¹⁴ Kjo ka qenë një pyetje e hapur, që u mundësonte të anketuarve të jepnin më shumë se një përgjigje, për këtë arsye shumica e gjithbarshme nuk mbërrin në 100%.

Institucionet shtetërore

Nuk është për t'u befusuar se institucionet e nivelit shtetëror siç janë Qeveria e Kosovës, Qeveria Qendrore e Serbisë ose Ministria e saj për Kosovë dhe Metohi vërtet gëzojnë vetëm besimin e zgjedhësve të tyre gjegjësisht shqiptarëve të Kosovës, ose serbëve të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës dhe bashkësitë tjera priren t'i besojnë Qeverisë së Kosovës (59.5% dhe 73%, përkatësisht), ndërsa serbët e Kosovës priren t'i besojnë Qeverisë Qendrore të Serbisë (64.5%). Në përgjithësi, sa më shumë njerëz që besojnë në institucionin gjegjësisht, aq më shumë kanë besim se ai institucion do të kontribuojë në përmirësimin e standardit të tyre të jetesës.

Institucionet ndërkombëtare

- **KFOR-i:** KFOR-i vjen pas PK-së si institucioni më i besueshëm në përgjithësi, me 76.1% e të anketuarve që i besojnë KFOR-it plotësisht ose shumë. Gjersa serbët e Kosovës kanë shumë më pak besim në KFOR sesa shqiptarët e Kosovës dhe bashkësitë e tjera, niveli i mosbesimit nga serbët e Kosovës në KFOR është më i vogël sesa në ofruesit e tjerë të sigurisë, përveç në policët serbë të Kosovës dhe në autoritetet lokale. Nivelet krahasimisht të larta të besimit duket që rrjedhin kryesisht nga roli që KFOR ka luajtur gjatë dhe menjëherë pas luftës. Se sa relevant shihen ata për të ofruar siguri sot varet shumë nga ajo se ku jetojnë njerëzit; për shqiptarët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, KFOR-i ende është një ofrues i rëndësishëm i sigurisë, "KFOR-i ofron siguri. Po të mos ishte KFOR-i këtu, nuk do të rrija as edhe një orë në Kosovë" (mashkull, 50 vjeçar, Mitrovicë). Të tjerët mendojnë se pasi që ka aktorë nacionalë të sigurisë siç janë PK-ja dhe FSK-ja, ka më pak nevojë për KFOR-in. Në mesin e këtyre të anketuarve, reduktimi i planifikuar në numër i KFOR-it gjerësisht shihet si një zhvillim pozitiv, si një tregues se gjendja e sigurisë është përmirësuar.
- **EULEX-i:** EULEX-i është i vendosur në fundin tjetër të kësaj shkalle me një nivel relativisht të ulët të besimit të përgjithshëm që është (33.6%), dhe për EULEX-in ka më pak divergjenca ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Në përgjithësi, të anketuarit mendojnë se pritjet e tyre për EULEX-in nuk janë përmbushur dhe EULEX-i kryesisht konsiderohet si zhgënjim. Shumë nga pjesëmarrësit e grupit të fokusit shprehën dyshimin për atë se a ka EULEX-i kapacitet t'u përgjigjet brengave të tyre të sigurisë, ose nëse angazhimi i EULEX-it ka rezultuar me ndryshime pozitive. Një e anketuar nga Prizreni, duke u përgjigjur në një pyetje se a ndjehej më e sigurt si rrjedhojë e pranisë së EULEX-it tha: "Jo, vërtetë. (...) EULEX-i nuk ka qenë në gjendje t'i mbrojë veturat e veta nga 'Vetëvendosja'¹⁵, si do të na mbrojnë neve?" (femër, 21 vjeçare, Prizren). Në të njëjtën kohë, njerëzit mendojnë se EULEX-i është duke pasur efekt pozitiv në punën e sektorëve të ndryshëm qeveritarë: 46.5% e të gjithë të anketuarve mendojnë se EULEX-i ka bërë punë të mirë ose shumë të mirë në përmirësimin e cilësisë së policisë. Efekti i EULEX-it në përmirësimin e punës së drejtësisë dhe të sektorit të doganave shihet si më pak i suksesshëm me 36% (drejtësia) dhe 30.1% (doganat) e të anketuarve thonë se efekti ka qenë i mirë ose shumë i mirë. Disa të anketuar e pranojnë dhe e njohin faktin se EULEX-i ka disa përparësi të caktuara krahasuese përkundrejt policisë: "Mendoj se pasi që ata janë këtu për drejtësinë, ndoshta duhet t'i lëmë të bëjnë punën e tyre. Ata kanë më shumë kompetenca se policia jonë dhe janë më të fuqishëm. EULEX-i është institucion i fuqishëm i BE-së i cili mund ta inkriminojë cilindo person të rëndësishëm këtu në Kosovë, pa marrë parasysh sa i pasur është, diçka që policia jonë asnjëherë nuk mund ta arrijë." (mashkull, 19 vjeçar, Ferizaj).

Politikisht, EULEX-i duhet të mbajë një baraspeshë delikate; aktualisht, si nga shqiptarët e Kosovës, e ashtu edhe nga serbët e Kosovës ai perceptohet si i njëanshëm

¹⁵ Vetëvendosja është një lëvizje që e kundërshton rolin mbikëqyrës të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, dhe kërkon sovranitet të plotë. Gjatë një proteste në gusht të vitit 2009, demonstruesit e Vetëvendosjes i kanë përmbysur 25 vetura të EULEX-it në Prishtinë.

dhe se punon kundër interesave të tyre. Ekziston një besim i kufizuar nga shqiptarët e Kosovës sa i përket bashkëpunimit të EULEX-it me Qeverinë e Kosovës: “Këtë herën e fundit ku ata nënshkruan marrëveshje me Ministrinë e Brendshme të Serbisë, ata nuk kanë bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës” (mashkull, 21 vjeçar, Ferizaj).

Përveç zhgënjimit me performancën e EULEX-it dhe pyetjet në lidhje me ‘lojalitetin’ politik, qëndrimi negativ ndaj EULEX-it duket që rrjedh edhe nga paaftësia e EULEX për ta definuar veten në mendjen e publikut, dhe të komunikojë qartë me qytetarët e Kosovës se si mandati, roli dhe përgjegjësitë e tij dallojnë nga ato të UNMIK-ut; 65.7% e të anketuarve “pajtohen” ose “pajtohen plotësisht” me deklaratën se nuk ka dallime të konsiderueshme ndërmjet EULEX-it dhe UNMIK-ut. Ky qëndrim është veçanërisht mbizotërues në mesin e banorëve urban dhe atyre që kanë më shumë arsimim, ndërsa ata me pak ose aspak arsim formal priren të përgjigjen me “nuk e di”: “UNMIK-u shkoi, EULEX-i erdhi; ku është dallimi?” (femër, 21 vjeçare, Prizren). Si rrjedhojë e këtyre perceptimeve negative, por edhe ndoshta nga ndjenja se funksionet e EULEX duhet të kryhen nga institucionet e Kosovës, gati gjysma (47%) e të gjithë të anketuarve pajtohen me deklaratën “EULEX-i duhet të largohet nga Kosova”. Shifra korresponduese për UNMIK-un është 69.8%.

Mungesa e transparencës dhe qasja e kufizuar në informata përkitazi me institucionet

Mungesa e transparencës për rolin dhe mandatin e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë këtu shumë pak informata ose jo në kohë, kontribuon në mungesën e përgjithshme të besimit dhe në pakënaqësi. Për institucionet kosovare të sigurisë, shumica e të cilave ende janë relativisht të reja, shkalla në të cilën njerëzit ndjehen të informuar në mënyrë adekuate për themelimin dhe funksionet e tyre ndryshon ndërmjet bashkësive, megjithëse tabloja e përgjithshme është se njerëzit nuk ndjehen të informuar mjaftueshëm. Në përgjithësi, serbët e Kosovës ndjehen se ata “nuk janë të informuar” ose “aspak të informuar” rreth themelimit të FSK-së dhe të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (shifrat ndërmjet 72% dhe 82.5%, përkatësisht). Të anketuarit shqiptarë të Kosovës ndjehen relativisht të informuar mirë lidhur me formimin e FSK-së, por ndajnë ndjenjën se nuk kanë marrë informata të mjaftueshme sa i përket themelimit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe Këshillit të Sigurisë së Kosovës (48.1% dhe 53.2% përkatësisht, ndjehen “të painformuar” ose “aspak të informuar”). Kjo me siguri pasqyron perceptimin se mandati i FSK-së është i definuar relativisht mirë dhe gëzon popullaritet të madh te shumë shqiptarë të Kosovës.

Në përgjithësi, të anketuarit raportojnë se ata nuk ndjejnë se ka informata të mjaftueshme në dispozicion rreth mandatit dhe përgjegjësisë të institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Niveli më i ulët i mbështetjes i është dhënë ICO/EUSR, me vetëm 11.6% e të anketuarve janë përgjigjur me “po” në pyetjen “A mendoni se ka informata të mjaftueshme në lidhje me mandatin/përgjegjësitë e [ICO- EUSR]?” Për EULEX-in, UNMIK-un dhe OSBE-në përgjigjet silleshin ndërmjet 22.5% dhe 26.7%. KFOR-i dallohet dhe krahasimisht shënon pikë të mira, me gati gjysmën e të anketuarve që ndjejnë se janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme. Fakti se njerëzit ndjehen të informuar më mirë rreth rolit të KFOR-it mbase është pjesërisht për shkak se KFOR shihet si mision ushtarak me fokus rigoroz që ndërlidhet me sigurinë dhe mbrojtjen, dhe se KFOR ka operuar në Kosovë për shumë vite, duke luajtur një rol të dukshëm në shumë bashkësi. Në të kundërtën, mandati i EULEX-it është më kompleks dhe më pak i qartë për njerëzit, siç u shtjellua më lart. Përveç kësaj, EULEX-i luan një rol më pak “të dukshëm”, dhe ende është relativisht i ri për kontekstin e Kosovës.


Mungesa e mundësive për pjesëmarrje më të madhe

Në përgjithësi, njerëzit nuk mendojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendim-marrje, madje edhe në nivelin lokal apo komunal. Më pak se një e treta (23.7%) e të anketuarve kanë dëgjuar për ndonjë takim me publikun të organizuar nga autoritetet komunale në 12 muajt e fundit, dhe vetëm një e katërta (26.4%) e të anketuarve mendojnë se pas takimeve të tilla, vendimet e marra nga autoritetet komunale kishin marrë parasysh brengat dhe opinionet e tyre të shprehura, (45.7% mendojnë se jo, 27.1% nuk janë të sigurt). Nëpër diskutimet në grupet e fokusit, njerëzit mendonin se autoritetet komunale nuk ishin të interesuara për opinionet e tyre dhe nëse nuk e njih kryetarin ose ndonjë pjesëtar me ndikim në administratën komunale, ose nuk jeni anëtar i partisë, brengat tuaja nuk do të adresohen.

Ekziston një dallim nëpër bashkësi në aspektin e niveleve të besimit në shprehjen e lirshme të pikëpamjeve nëpër takimet publike: gjersa dy të tretat (64.9%) e shqiptarëve të Kosovës mendojnë se ata mund t'i ndajnë mendimet dhe opinionet e tyre lirisht pa pasur frikë për ndonjë pasojë negative, vetëm 50% e serbëve të Kosovës dhe 43% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera ndjejnë të njëjtën gjë.

Megjithëse rezultatet e mësipërme sugjerojnë se njerëzit nuk kanë shumë besim në rolin ose rezultatet e takimeve të komunave me publikun, ka perceptime të përziera sa i përket asaj se a janë në gjendje pjesëtarët e bashkësisë të ndikojnë në vendim-marrjen e qeverisjes lokale. Megjithëse në përgjithësi, 40.2% e të anketuarve mendojnë se pjesëtarët e bashkësisë kanë “deri diku” ose “shumë” ndikim në vendimet që merren nga qeverisja lokale, 47.5% nuk pajtohen me një gjë të tillë. Ekzistojnë dallime rajonale mjaft të konsiderueshme, siç mund të shihet nga diagrami më poshtë, ku shumica e të anketuarve në Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Ferizaj japin përgjigje negative, ndërsa qytetarët në Mitrovicë, Prizren dhe Gjakovë janë më optimistë për mundësinë e ndikimit në qeverisjen lokale.

Figura 6: Sa ndikim mendoni se kanë njerëzit e komunitetit tuaj në vendimet që merren nga qeveria juaj lokale?



Nivelet e arsimit po ashtu duket se luanë një rol sa u përket perceptimeve të njerëzve përkitazi me atë se a mund të ndikojnë ata në vendim-marrje apo jo. Njerëzit me nivele më të ulëta të arsimit formal duket se mendojnë se janë më pak të përfshirë në proceset vendim-marrëse. Ata rrallë janë në dijeni të mundësive për të ndikuar në vendim-marrje, siç janë takimet me publikun, dhe ka më shumë të ngjarë të përgjigjen me “nuk e di”, kur pyeten se brengat e shtruara në takimet e tilla do të kenë ndonjë ndikim në vendimet që merren. Kur pyeten sesa ndikim në përgjithësi njerëzit në bashkësinë e tyre kanë në vendimet e marra nga qeverisja lokale, asnjë i anketuar me pak arsimim formal nuk është raportuar të ketë thënë se ato kanë shumë ndikim dhe vetëm 16.9% kanë thënë se kanë ndikim deri në njëfarë shkalle. Për dallim nga kjo, ata me arsimim më të lartë dhe diploma universitare duket se janë më me vetëbesim me 32.5% që deklarojnë se ata kanë deri diku ndikim dhe 9.9% që deklarojnë se kanë shumë ndikim.

Angazhimi qytetar

Megjithëse njerëzit duket se besojnë se mundësitë e tyre për të ndikuar tek autoritetet lokale janë të kufizuara, por duket se ka gatishmëri të konsiderueshme për t'u angazhuar vullnetarisht në bashkësinë lokale në çështjet që i preokupojnë njerëzit drejtpërdrejt, siç janë mjedisi, rendi dhe siguria lokale. Shumica dërmuese (81.4%) e të anketuarve thanë se do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në ndonjë projekt për pastrim që organizohet nga bashkësia në baza vullnetare nëse do të organizohej diçka e tillë. Nëse projekti ka të bëjë me ndonjë aktivitet për të përmirësuar rendin ose sigurinë, shifra është 76.7%. Kjo është veçanërisht kështu në zonat ku mungesa e rendit dhe e sigurisë është një brengë e vazhdueshme: për shembull, 82.5% e të anketuarve nga Mitrovica deklaruan se ata do të ishin të gatshëm ose shumë të gatshëm që të marrin pjesë në projektet për siguri në bashkësi.

Kur ndodhin aktivitete të bashkësisë, ato shpesh organizohen nga komunitet dhe kryesisht kanë të bëjnë me çështjet mjedisore siç janë pastrimi i mbeturinave. Këto aktivitete janë më të shpeshta në zonat rurale sesa në ato urbane, dhe të rinjtë duket të jenë më aktivë se gjeneratat e vjetra. Shumë njerëz raportojnë se ka pasur më shumë angazhim vullnetar në bashkësi në të kaluarën sesa që ka sot, pjesërisht, siç thuhet, për arsye se njerëzit në ditët e sotme më shumë mbështeten në autoritetet lokale ose në të tjerë, sesa që marrin vetë iniciativa.

Aktualisht, vetëm 6.4% prej të gjithë të anketuarve janë anëtarë të ndonjë organizate ose asociacioni (duke mos marrë parasysh këtu anëtarësinë të ndërlidhur me vendin e punës), dhe nga këto më shumë se gjysma janë anëtarë të ndonjë partie politike. Duket se ka korrelacion të qartë ndërmjet nivelit të arsimit dhe angazhimit vullnetar: 13.8% e të anketuarve me arsim të lartë dhe 19.4% të atyre që kanë mbaruar universitetin janë anëtarë të ndonjë organizate/asociacioni, krahasuar me asnjë prej atyre që nuk kanë arsimim formal dhe vetëm 1.1% të atyre që kanë të kryer shkollimin fillor. Gati tri herë më shumë meshkuj se femra janë të përfshirë në organizatat formale (9.1% kundrejt 3.5%); nga gratë që janë anëtare të ndonjë organizate, 30% janë anëtare të ndonjë partie politike (krahasuar me 59.6% të meshkujve), dhe 25% janë anëtare të grupeve të grave.

Rekomandimet

NË KËTË PJESË IDENTIFIKOHEN rekomandimet që duhet të merren në konsideratë nga vendim-marrësit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike në Kosovë. Ato janë nxjerrë nga analiza e të dhënave nga hulumtimi i përshkruar më lart, i cili i kombinon opinionet e publikut me ato të formuesve të opinioneve dhe profesionistëve përgjegjës për zbatim të ligjit dhe ofrim të sigurisë.

Këto rekomandime janë paramenduar si një kontribut konstruktiv për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve të porsa-krijuara të Kosovës, përgjegjëse për aspekte të ndryshme të rendit dhe të sigurisë publike. Hulumtimi sugjeron se njësoj sikurse Kosova që po vazhdon të zhvillohet, ashtu edhe perceptimet e qytetarëve të saj ndaj këtyre strukturave dhe institucioneve po bëhen më pozitive. Autorët kanë qenë në gjendje të identifikojnë trende të qarta dhe pozitive që nga anketa e parë në këtë seri që u realizua në vitin 2006. Megjithatë, ekzistojnë trende të cilat mbeten të dukshme këtë vit gjë që do të kërkojë energji dhe vëmendje shtesë nëse dëshirohet që ato të trajtohen në muajt dhe vitet që vijnë. Këtu hyjnë:

- Perceptimet për institucionet shtetërore janë tepër të kushtëzuara nga përkatësia etnike e qytetarit.
- Perceptimet për efikasitetin e institucioneve lokale, duke përfshirë autoritetet komunale varen shumë nga konteksti lokal; nëse kryetari lokal konsiderohet efikas, vetëm atëherë institucionet e qeverisë priren të respektohen mirë.
- Institucionet e Kosovës duket se po bëhen më të popullarizuara dhe të besuara nga shumica e popullatës. Ndonëse është më pak e qartë se nëse ky trend pozitiv pasqyrohet në mesin e pjesëve më pak të fuqishme të qytetarisë së Kosovës, duke përfshirë etnitë jo-shqiptare, gratë, të rinjtë dhe ata me nivel të ulët të edukimit formal.
- Prania ndërkombëtare në Kosovë me përgjegjësinë për çështjet e sigurisë dhe të drejtësisë mbetet e kontestuar. Prania e konsoliduar e KFOR-it, me mandat të qartë dhe të kuptuar mirë duket të jetë më e besueshme nga të gjitha bashkësitë. EULEX-i kuptohet dhe besohet shumë më pak. Arsyet për këtë janë jashtë fushëveprimit të këtij projekti të hulumtimit, por mund të jetë ajo se vështirësitë në të shpjeguarit e natyrës së 'neutralitetit ndaj statusit' të pranisë së BE-së në Kosovë dërgojnë sinjale hutuese për të gjitha palët.
- Megjithë sfidat në vazhdimësi me të cilat po përballet Kosova dhe ofruesit ndërkombëtarë të sigurisë në atë që të bindin popullatën e përgjithshme se atyre duhet t'u besohet, ekziston një sens i qartë dhe inkurajues i përgjegjësisë së bashkësisë në Kosovë, i cili nuk pasqyrohet në shkallë të njëjtë në vendet e tjera në të cilat autorët kanë realizuar hulumtime të ngjashme. Ekzistimi i një kapitali social të tillë paraqet

një mundësi të mirë për qeverinë dhe të tjerët, siç janë aktorët ndërkombëtarë, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare; nëse ata punojnë mirë dhe demonstrojnë llogaridhënie dhe efektshmëri, ka të ngjarë që ata të shpërblehen me mbështetje të konsiderueshme nga qytetarët e tyre.

**Ngritja në shkallë
edhe më të lartë
të efikasitetit të
institucioneve të
Kosovës**

- **Në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe të Planit të Veprimit për Sigurinë në Bashkësi, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë konsultim të gjerë dhe të marrë parasysh përvojat nga nismat e suksesshme të sigurisë në bashkësi në nivelin lokal dhe atë qendror.**
- **Qeveria e Kosovës dhe aktorët tjerë duhet t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar mëtej performancën e Policisë së Kosovës.** Në mënyrë që të shtohet besimi në polici si ofrues legjitim i sigurisë, është e nevojshme të rritet mëtej niveli i kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përmirësimit të aftësisë së policisë për të reaguar shpejt ndaj incidenteve, si dhe për të siguruar konfidencialitetin e informatave të pranuar. Nevojitet përmirësim i mëtejshëm në marrëdhëniet ndërmjet PK-së dhe serbëve të Kosovës. Përparimi i arritur në performancën e policisë duhet t'i komunikohet publikut si mjet i vlefshëm për ndërtimin e besimit të publikut dhe të besimit në institucionin e policisë.
- **Duhet të aplikohet qasje gjithëpërfshirëse në promovimin e sigurisë në bashkësi, ku do të përfshiheshin ministrinë kryesore dhe aktorët tjerë në sektorë siç janë zhvillimi i infrastrukturës, drejtësia, shëndetësia, administrata lokale dhe ekonomia.** Meqë shumica e brengave të rendit dhe të sigurisë nuk ndërlidhen me përgjegjësitë kryesore të ofruesve të sigurisë, aktorët tjerë kyç duhet të përfshihen aktivisht në zhvillimin e politikave të përshtatshme dhe të mekanizmave në nivel kombëtar dhe komunal, e po ashtu edhe në trajtimin e brengave përkitazi me rendin dhe sigurinë në nivel lokal.

**Ngritja në shkallë
edhe më të lartë
të mirëkuptimit,
dhe të angazhimit
me agjencitë
ndërkombëtare të
interesuara për rendin
dhe sigurinë publike
në Kosovë**

- **Për ta ngritur në një shkallë më të lartë besimin e tij në publik, EULEX-i duhet t'i shqyrtojë mënyrat për rritjen e shkallës së komunikimit me qytetarët me qëllim të sqarimit të rolit dhe përgjegjësisë të tij dhe për t'i vënë në pah arritjet e tij deri më sot.** Kjo do të mund të arrihej përmes vënies së theksit më të madh në shtrirjen e kontaktit të drejtpërdrejt me bashkësitë, me vizita nëpër universitete dhe shkolla të mesme, takime me qytetarë dhe ngjarje të tjera publike, nëpër të cilat njerëzit e zakonshëm do të kishin mundësi të shtrojnë pyetje dhe të ngrisinin zërin për pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.
- **Institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-i duhet t'i përmirësojnë strategjitë e tyre të koordinimit dhe të komunikimit.** Deklaratat publike të cilat duken kundërthënëse, mund të shërbejnë në zvogëlimin e mëtejshëm të besimit në EULEX dhe ta frenojnë progresin në përmbushje të mandatit të tij.

**Angazhim më efektiv
me publikun e Kosovës**

- **Informata më të bollshme dhe më cilësore duhet të vihen në dispozicion të qytetarëve rreth punës dhe qasjes në institucionet e ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë.** Këtu duhet të përfshihen KKSb-të, por edhe institucionet e "reja" siç janë Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK). Në komunat e porsa-formuara, veçanërisht në ato me shumicë serbe, kjo duhet të bëhet me institucionet e Kosovës përgjithësisht, meqë tani për tani ka pak mirëkuptim për funksionet e tyre ose besim në aftësinë e tyre për t'i përmbushur këto funksione në mënyrë të ndershme.

- **Duhet të përmirësohen mundësitë për angazhim të qytetarëve, si dhe duhet të rritet sensibilizimi i publikut për çdo mundësi ekzistuese për angazhim.** Kjo nuk vlen vetëm për çështjet që lidhen me rendin dhe sigurinë, por me pjesëmarrjen e përgjithshme qytetare në çështjet e bashkësisë. Përpjekjet në këtë drejtim duhet t'i përfshijnë të gjitha elementet e shoqërisë, përfshirë këtu edhe njerëzit, zëri i të cilëve zakonisht nuk dëgjohet, domethënë gratë, të rinjtë dhe grupet e pakicave etnike.
- **Autoritetet lokale duhet të mbështesin gatishmërinë e publikut për t'u angazhuar vullnetarisht në aktivitetet e bashkësive lokale, në çështjet që i preokupojnë drejtpërdrejt njerëzit.** Ekzistimi i KKSBB-ve dhe i forumeve të tera për siguri në nivel të bashkësisë u ofron mundësi autoriteteve lokale që ta shtrijnë kontaktin deri te këto grupe, zëri i të cilëve zakonisht nuk dëgjohet, siç janë të rinjtë, gratë dhe pakicat, si dhe t'i nxisin dhe mbështesin nismat që do të ndihmonin ambientin e tyre lokal dhe gjendjen e sigurisë.

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare e përqëndruar në zbatimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqa dhe drejtësia.

Saferworld punon për të parandaluar dhe zvogëluar konfliktet e dhunshme dhe për të promovuar qasjet bashkëpunuese ndaj sigurisë. Ne punojmë me qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për të inkurajuar dhe mbështetur politikat dhe praktikat efektive përmes avokimit, hulumtimit dhe zhvillimit të politikave dhe përmes mbështetjes së veprimeve të tjerëve.

FOTO NË BALLINË: Zyrtar i Policisë në rrugët e Prishtinës. DRITON PAÇARADA



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)
Rr. Bedri Pejani 7/A
10000 Prishtinë
Kosovë
Tel: + 381 (0)38 248 677
Web: www.fiq-fci.org

Saferworld
The Grayston Centre
28 Charles Square
London N1 6HT
UK
Phone: +44 (0)20 7324 4646
Fax: +44 (0)20 7324 4647
Email: general@saferworld.org.uk
Web: www.saferworld.org.uk